



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E SHTIMES
MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

Procesverbal nga mbledhja e IV- të KKSBB-së e mbajtur më 29 shtator (e hënë) 2025, në ora 10:00, në Sallën e vogël të Ndërtesës së Komunës.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Nënkryetari i Komunës së Shtimes Faruk Beqa, Besnik Ahmeti (DFB), Xhavit Bungu (KP), Shpresim Mahmuti (Shoqëria Civile), Muhadin Halili (EVSBB), Haxhi Behluli (Policia Shtime), Armend Bikliqi (FSK), Skender Dauti (Përgjegjës për siguri), Bajram Gashi (NJPLSH), Reshat Gashi (ZDGJ- ZKD) dhe Vlora Hyseni (ZI).

Faruk Beqa: Përshëndet të pranishmit dhe fillon me leximin e rendit të ditës.

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 20.6.2025;
2. Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin Janar-Qershor 2025
3. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;
4. Informatë nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
5. Informatë nga Drejtoria e Arsimit
6. Të ndryshme

Ne po fillojmë, siç është e rrugës, me aprovimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Besoj që gjithçka është korrekte edhe në procesverbal, andaj do të votojmë me ngritje dore për ta aprovuar. Ju faleminderit, pra të gjithë jemi që të kalojë. Do të lutesha që dikush të na e lexojë, edhe në pika të shkurtra, që të informohemi për raportin. Vlora?

Vlora Hyseni: Për 6 muaj janë të gjitha pikat, vetëm 3 pikat janë këtu të përmbledhura, por është prezantuar edhe në mbledhjen e Kuvendit.

Faruk Beqa: Në rregull. Me ngritje dore aprovojmë raportin informues në pikën e dytë të rendit të ditës. Kush është për?

(Aprovohet unanimisht)

Faruk Beqa: Mirë shumë. Faleminderit. Kjo është pika e tretë e rendit të ditës, dhe për këtë e kemi komandantin e Policisë në Shtime, z. Haxhi Behluli.

Haxhi Behluli: Ju përshëndes të gjithëve. Dua të ndaj me ju një pasqyrë më të thjeshtë dhe më të detajuar që të kuptohet situata. Raporti bazohet në statistikat që Policia i nxjerr gjithmonë, duke bërë vlerësimin nga organet si Policia, e herë-herë edhe nga FSK, KFOR dhe intelijenca brenda Policisë. Rajoni ynë është në gjendje të kontrolluar dhe jemi në rrugë të mbarë, megjithëse ka sfida të herëpashershme. Gjendja konsiderohet stabile.

Sipas statistikave, nga 01.01.2024 deri më 29.09.2024 kemi regjistruar 333 raste, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit 2025 - 328 raste, që do të thotë kemi 5 raste më pak. Këtu përfshihen edhe aksidentet në trafik.

- Në vitin 2024 kishim 94 aksidente, kurse në 2025 - 99 aksidente (rritje).
- Rastet me fatalitet: asnjë.
- Raste me lëndime të lehta: 99 të regjistruara.
- Dhunë në familje: 22 raste në 2024, ndërsa 32 në 2025 (rritje).
- Kanosje: nga 20 raste në 25 (rritje prej 5 rastesh).
- Lëndime të lehta: nga 20 në 23 raste.
- Lëndime të rënda: nga 4 në 2 raste (ulje).
- Vjedhje: nga 20 në 26 raste (rritje).
- Vjedhje të rënda: nga 27 në 22 raste (ulje).
- Hyrje në sisteme kompjuterike: nga 5 raste në 0.
- Ndotja e ambientit: nga 0 në 1 rast.
- Armëmbajtje pa leje: nga 16 në 22 raste (rritje).
- Sulm ndaj personit zyrtar: nga 4 në 2 raste (ulje).
- Zjarrvënie: nga 4 në 5 raste. Këto situata janë trajtuar edhe nga inspektorët komunalë.

Siguria në komunikacionin rrugor:

- Gjopa të shqiptuara: 3,522 në 2024 dhe 2,656 në 2025.

Njësitë policore janë angazhuar edhe në zbatimin e udhëzimeve, dhe si rezultat, është ulur numri i rasteve aktive që kemi në listat nga Gjykata. Te zjarret, bashkëpunimin e kemi edhe me FSK-në. Komunën e falënderojmë që ka qenë në bashkëpunim me ne. E zgjata pak, por u mundova. Ju faleminderit.

Faruk Beqa: Ju faleminderit komandant për informatat. Rregulli e kërkon që ne të hapim debatin edhe për këtë informatë. A ka dikush tjetër diçka për të shtuar në lidhje me informatat që na dha komandanti?

Para se të marrë dikush fjalën, unë e di që në buxhet është planifikuar edhe vendosja e kamerave nëpër fshatra. Ndoshta është mirë të koordinohemi edhe me KFOR-in.

Besnik Ahmeti: Po, në buxhet është planifikuar, por fatkeqësisht buxheti ende nuk ka kaluar.

Faruk Beqa: Buxheti deri në prill s'ka çare pa u miratu. Po, Muhadin?

Muhadin Halili: Kamerat nuk e di saktësisht se ku dhe si do të vendosen, por si informatë po e jap që nesër do të nënshkruhet kontrata, ku vlera është diku rreth 18 mijë euro nëse nuk gaboj. Këtë informatë po e jap nga dora e parë.

Po ashtu kam një shqetësim dhe një pyetje lidhur me sigurinë në komunikacion. Unë jetoj në rrugën 'William Walker'. Aty më herët kanë qenë disa pengesa që ndalonin pak shpejtësinë e automjeteve. Tani ato pengesa janë hequr, dhe disa individë po zhvillojnë shpejtësi të lartë, sikur të ishte autostradë.

Përkundër se sinjalizimi është vendosur, ka tejkalime të shpejtësisë dhe është rrezik për fëmijët që shkojnë në shkollë. Kur do të vendosen prapë pengesat, se ndryshe ata nuk ndalen? Ose të paktën të ketë ndonjë patrullë policore po e ngre këtë si shqetësim. Ju faleminderit shumë.

Haxhi Behluli: Për këtë rast e di situatën. Mendoj që kemi me vendosë pika kontrolli. Është edhe çështje e mungesës së stafit, por gjithsesi kjo është prioritet. Te kamerat desha të lidhem ku do të vendosen, dhe prej kujt do të kontrollohen?

Muhadin Halili: Mundesh me bisedu me Drejtorin e Shërbimeve Publike, me Bardhin, për të lënë ndonjë takim ose për t'u koordinuar.

Faruk Beqa: Kish qenë më mirë me radarë fiks, si në Zvicër p.sh. Se 2700 tiketa për shpejtësi është e palogjikshme. Atëherë vazhdojmë me pikën e pestë e rendit të ditës. Urdhëro, Armend.

Armend Bikliqi: Përshëndetje për të gjithë. Jam rreshter Armend Bikliqi, shef i inteligjencës, dhe është hera e dytë që po marr pjesë në takim me ju. Nënkyetar, nuk kam shumë çfarë të shtoj për sa i përket sigurisë në Komunën e Shtimes, por nëse më lejoni, do të flas dy minuta në përgjithësi.

Pa dyshim që nëse rrezikohet Kosova në tërësi, edhe Shtimja është pjesë e saj. Diçka që për ne është shqetësim është shkelja e hapësirës ajrore në kufi me Serbinë.

Ne jemi duke punuar ngushtë me Policinë e Kosovës, gjithashtu duke monitoruar edhe aktivitetet

e bazave në afërsi të kufirit të Kosovës. FSK është duke u përgatitur edhe në aspektin e burimeve njerëzore. Në territorin tonë kemi pasur rekrutime të reja dhe kemi marrë staf të ri.

Derisa e kemi KFOR-in këtu, jemi duke i forcuar kapacitetet tona, por padyshim që anëtarësimi i Kosovës në NATO do ta rriste edhe më shumë këtë siguri. Më falni nëse dola pak jashtë temës, por desha të jap një pasqyrë.

Faruk Beqa: Ju faleminderit, rreshter, për informatat shumë të rëndësishme. Kosova është një prej shteteve më të sigurta për sa kohë kemi KFOR-in, dhe nuk kemi ndonjë telashe. Po ashtu, me kapacitetet tona jemi në rrugë të mbarë dhe jemi duke u forcuar.

Ju faleminderit shumë, i nderuar. A ka dikush tjetër diçka për të shtuar, apo të vazhdojmë më tutje? Drejtorin e Financave e kemi këtu. Ia japim fjalën Besnikut kjo është pika e gjashtë e rendit të ditës."

Besnik Ahmeti: Përshëndetje për të gjithë. Drejtoria e Financave këtë vit ka kryer auditimin paraprak dhe, fatkeqësisht, ka dalë si i kualifikuar. Përndryshe, raporti është ndër më të mirët për nga transparenca buxhetore, por kontratat kolektive e kanë ndikuar që të jetë i kualifikuar, sepse janë përfshirë në kategori të tjera. Sa i përket buxhetit, mbi 72% është shpenzuar dhe presim që deri në fund të vitit të arrijmë 98-99%.

Tash jemi në tremujorin e tretë. Të hyrat vetanake janë 858 mijë euro.

Pas ardhjes së qarkores buxhetore, menjëherë kemi filluar përgatitjen e buxhetit.

Ka shkuar në diskutim publik në muajin qershor në të gjitha fshatrat dhe është rikthyer në Kuvend si draft. Buxheti total ka qenë: 11,443,985 euro, shërbimet: 1.5 milion, subvencionet: 500 mijë, investimet kapitale: 2.5 milionë euro. Pas qarkores së dytë kemi mbajtur përsëri dëgjime publike në Kuvend me partitë politike, organizata të ndryshme dhe klube sportive.

Sa i përket pjesëmarrjes, nuk ka qenë e kënaqshme kanë marrë pjesë vetëm dy asambleistë në fshatrat e tyre. I kam ftuar edhe personalisht që, nëse nuk vijnë në dëgjime publike, të vijnë në zyrën time për t'u dakorduar për buxhetin. Qëllimi është të bëjmë buxhetin më të mirë të mundshëm. Për momentin, buxheti ende nuk ka kaluar, ju faleminderit.

Faruk Beqa: Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen dhe kontributet që dhamë në këtë mbledhje. Diskutuam disa çështje të rëndësishme, si siguria, buxheti, dhe investimet në kamerat e sigurisë. Kemi marrë informacione të dobishme dhe kemi ngritur shqetësime që duhet të merren parasysh. Shihemi në mbledhjen e ardhshme.

Mbledhja ka përfunduar në ora 11:30






Procesmbajtës:

Vlora Hyseni



Lista e pjesëmarrësve në mbledhjen e -IV-të, të KKSB

Shtime, 29 shtator 2025

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	Reshat Gashi	ZOGJ - ZKD	
2	Muhamet Mehmeti	ZKKK	
3	Shender Daceti	Përzgjedhës në Bijëri	
4	Armend Bickliqi	FSK	
5	Bajram Gashi	ATTE/NDPSH	
6	Xhavit Bungu	Këshilli i Prindërve	
7	Shpëtim Mahmuti	Shogëri Civile	
8	Muhamdin Holli	ERSB	
9	BESIR AHMETI	DREJTOR I FINANCAR	
10	Haxhi BASHKI	POLICIA SHATIME	
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			